



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1653 Prot.

Roskovec, më 26, 02 2026

VENDIM

NR 6 . DATË 26 . 02 . 2026

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2026”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.01.2026, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2026.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 685/1 Prot.

Roskovec, më 30.01.2026

Procesverbal Nr.1

-I mbajtur sot, datë 29.01.2026, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2025.
5. Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2026.
6. Për miratim të projekteve prioritare infrastrukturore për Bashkinë Roskovec për vitin 2026.
7. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁴

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, A.Pelo.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, E.Kaçeli, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, V.Çepele, S.Bibo Qami, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Sekretare e Përgjithshme D.Hoxha, P/Shërbimit Social E.Kola, Dr.Urbanistikës E.Hoxha, Dr.Ekonomik O.Goga.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltarë. Kryetari –mirdita të gjithëve dhe faleminderit që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë të datës 29.01.2026. Duke qënë se kuorumi i nevojshëm i këshilltarëve në sallë për zhvillimin e kësaj mbledhje së kësaj date është, unë e deklaroj mbledhjen të hapur. Me rendin e ditës jeni njohur që në datën 23.01.2026, rendi i ditës i përcaktuar nuk ka asnjë ndryshim, ndaj unë e paraqesë përpara jush për votim rendin e ditës së kësaj mbledhje.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet rendi i ditës dhe i hapet rruga e zhvillimit të kësaj mbledhje sipas rendit të paracaktuar.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2025.

Kryetari-ju ftoj të nderuar këshilltar të dëgjojmë një informacion të shkurtër nga ana e Sekretares së Këshillit në lidhje me vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2025, dhe duke qënë se kjo është mbledhja e parë e këtij viti, uroj që të kemi mbledhje sa më frytdhënëse dhe me një prani të admirueshme, të paktën kështu si jemi sot në këtë sallë. Sekretarja e Këshillit-përsëndetje, ju bëj me dije në lidhje me vendimet e miratuara në mbledhjen e fundit të muajit Dhjetor, e cila ishte edhe mbledhja e fundit për vitin 2025, ku ju keni miratuar gjithësej 6 vendime , nga të cilat 2 prej tyre ishin vendime me karakter normativ, të cilat i kemi dërguar në Prefekturë për verifikim ligjor. Sekretarja përmend vendimet normative. Të dy vendimet janë miratuar nga Prefektura. Të gjitha vendimet u janë dërguar zyrove për zbatime të mëtejshme ligjore.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- me procesverbalin e kësaj mbledhje ju jeni njohur të gjithë. Në ndryshim nga herët e tjera, e keni vënë re që e kemi pasur procesverbalin të pashtypur, për arsye se materjali ka qënë voluminoz dhe koha e shkurtër, nuk besoj se kjo ka penguar asnjërin nga ju që të marri informacionin e duhur në lidhje me këtë procesverbal, ndaj ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë procesverbalin Nr.12, të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2025.

Kryetari- ndërkohë që presim që të na bashkohet specialistja për relatimin e këtij projekt-vendimi, jeni të lutur ashtu siç kemi rënë dakort, në qoftë se nuk është e nevojshme leximi i relacionit, mund të shpreheni..Këshilltarët shprehen-kaloje në votim. Kryetari- atëherë për pyetje? Nuk ka. Kryetari-atëherë me sugjerimin e këshilltarëve të pranishëm ju falenderojë, ne po e kalojmë në votim projekt-vendimin “Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim.

5.Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike,nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2026.

Kryetari-dëshironi që shkurtimisht të dëgjojmë relacionin, apo mjafton njohja që keni pasur? Leksi-të njëjtat kritere janë..Elmazi-nuk ka ndonjë ndryshim në kriteret që kanë qënë për ti kaluar për diskutim, prandaj ta kalojmë..Kryetari-për procedurë po ju pyes ka dikush pyetje ose..Jorgo-ka ndonjë kriter shtesë? P/Shërbimit Social Enkeleda-jo, vazhdojnë po të njëjtat kritere. Jorgo-për ndihmën? Enkeleda-po flasim për 6%, vazhdojnë po të njëjtat kritere. Jorgo-ka ndonjë kriter shtesë? Enkeleda-jo, kriter shtesë nuk ka. Jorgo-janë të njëjtat që përfitojnë? Enkeleda-emrat i ndryshojmë në varësi të aplikimeve që na bëhen çdo muaj dhe në varësi të gjendjes ekonomike që ne shikojmë nëpër familje. Jorgo-në çdo muaj? Enkeleda-jo në çdo muaj sepse ne kemi..Jorgo-po ju e thatë..Enkeleda-tani këto janë kriteret e 6% që ne duhet të zgjedhim familjet gjatë vitit 2026, kjo pikë që po kalojmë tani. Jorgo-kjo vëzhgohet në 12 muaj apo? Enkeleda- kriteret janë të njëjta, miratohen..Jorgo-1 herë në 12 muaj? Enkeleda-po, 1 herë në vit, 1 herë në 12 muaj. Jorgo-ka ndryshim? Enkeleda-jo, janë po të njëjtat. Kryetari-dikush tjetër për pyetje apo diskutim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës e kërkon fjalën? Atëherë për sa kohë nuk kemi pyetje dhe diskutime në lidhje me projekt-vendimin, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike,nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet ky projekt-vendim.

6.Për miratim të projekteve prioritare infrastrukture për Bashkinë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari-presim pak çaste sa në foltore të afrohet specialistja e cila do të relatojë këtë projekt-vendim. Dr.Urbanistikes Eneida-të nderuar këshilltar, ju paraqesim për miratim projekt-vendimin “Për miratim të projekteve prioritare infrastrukture për Bashkinë Roskovec për vitin 2026”. Ashtu si çdo vit tjetër, në fillim të vitit miratohen projektet prioritare duke u bazuar nga nevojat që kanë lindur gjatë vitit të kaluar, nga mundësitë që na krijohen për aplikime për thirrje dhe nga projekte që ne kemi të mbartura. Projektet prioritare për këtë vit janë 32, fillon ti përmend sipas radhës..Amarildo-o Kryetar materialin e kanë të gjithë, të bëjmë ndonjë pyetje ne? Kryetari-dëgjo për procedurë detyrimi i saj është që të lexojë relacionin, për sa kohë këshilltarët e nderuar janë njohur dhe nuk kanë mëdyshje sa i takon relacionit, kalojmë në seancën e pyetjeve. Cili nga këshilltarët kërkon fjalën për pyetje? Po z.Amarildo dhe përgatitet znj.Mira. Amarildo-faleminderit Kryetar. Kjo është pak a shumë e njëjta pasqyrë, e njëjta renditje që shohim çdo vit në projektet prioritare. Unë do të isha më mirë që ju të kishit 5, 3, 10 çrëndësi ka, por tek ato të mëshonit më fort, ato që janë më urgjente për tu bërë në territorin e bashkisë tonë, se për fat ne nuk jemi dhe ndonjë bashki e madhe në këndvështrimin tim, dhe tjetra shikoj këtu përsëri keni për pjesën e përroit të Vidhishtës. Ju keni mandatin e tretë qeverisës në bashki dhe mandatin e katërt në pushtet. Për fatin e mirë tuajin apo të keq i keni patur të dy pushtetet, si qëndror si lokal, besoj se është kërkesë që e bëj unë e pesta, e gjashta herë, jo rehabilitim duhet ndërhyrje. Nuk pret më puna atje sepse ju e shikoni çdo vit, reshje nuk ka, atje nuk ka më as ujë ai përroi sepse liqeni i Kurjanit është tharë, ka vite që nuk funksionon dhe unë shikoj që duhet ndërhyrje jo rehabilitim, dhe më e bukura nga të gjitha qëndron sepse në projektet prioritare që keni sjellë nuk shikoj asgjëkundi aty në Vidhishtë nuk ka fare kanalizim të ujrave të zeza dhe nuk e di si e ka menduar bashkia, ndoshta këta demokratë janë ka thënë dhe ranë nga pushteti, nuk hanë dhe pijnë më këta tani, po ua garantojë që hamë dhe pijnë mirë. Kështu që duhet të ishte e para ujrat e zeza sepse nuk ka

kanalizime, nuk shkohet në Europë kështu se e keni nisur sëprapthi, ujrat e zeza nuk derdhen më shesheve, përrrenjve, lumenjve apo ku di unë, duhet sesbën të ketë kanalizime, në rast se kërkoni vërtet ti bëni megjithëse unë e di pse nuk realizohet dhe nuk keni për ta realizuar asnjëherë atë përroin e Vidhishtës, por unë jam i detyruar ta kërkojë duke qënë se jam përfaqësues i atyre qytetarëve, unë e di dhe një pjesë e mirë e banorëve e dinë që nuk do ta realizoni..Kryetari-z.Amarildo të lutem jemi te seanca e pyetjeve..Amarildo-po pikërisht, pyetje po bëj..Kryetari-fokusohuni tek pyetja dhe mund ta merrni fjalën për diskutim në qoftë se keni diskutim pak më të përmbledhur..Amarildo-ta përmbledh, tani unë kam një sugjerim, atje ka mundësi për ta bërë jo nuk ka, nuk ka vullnet dhe dëshirë, e bëni me lote në rast se nuk e bëni dot njëherë, me lote ju e keni qejf këtë pjesën e loteve, megjithatë prapë është e pranueshme vetëm ta realizoni..Kryetari-të lutem tani..Amarildo-po mbarova për pjesën e përroit, dhe tjetra shikoj dhe shkollën, keni shënuar rikonstruksion shkolle megjithëse unë doja të ishte një midis Maksit dhe Kryetares sot. Keni shënuar dhe shkollën, ka qënë vet Ministria ka thënë që do e realizojmë në një bashkëpunim, ku di me kë e kishin, e shoh prapë të shënuar këtu. Ka ndonjë plan konkret për ta realizuar, keni ndonjë informacion si do bëhet me këtë shkollën? Shoh çdo vit shtresa asfalti, çakull pafund. Është problem, nuk e di Kryetari i fshatit besoj se e ka ngritur ose nuk e ka ngritur se di, ka lagje të tëra që nuk kanë rrugë për të shkuar te parcelat e ullinjve, flasim për rrugën që është nga pompa e fshatit Vidhishtë deri lart, është 80% e fshatit që kanë ullahtet dhe i nxjerrin ullinj të në krahë, bëhet fjalë për 1 km rrugë, nuk kërkojnë ata zotrinjtë që ta bëni me asfalt, kërkonin që këtë çakullin që shënoni këtu ta hidhni atje në realitet. Bashkëpunoni me kryetarët e fshatrave, ti dinë edhe ata ku kalojnë fshatarët e tyre se shumicën e rrugëve ata sbesoj ta dinë fare, por tek kjo rrugë janë 80% e familjeve të atij fshati që e kanë të domosdoshme për të nxjerrë prodhimet e tyre. Kalojnë dhe të majtë dhe të djathtë atje, nuk kalojnë vetëm të djathtët kjo është e sigurt, kaq kisha unë faleminderit. Eneida-përsa i përketë projekteve prioritare, çdo vit ato azhornohen, disa janë realizuar, disa janë për tu realizuar. Një ndër to siç thatë është dhe shkolla e Vidhishtës, e cila është projekt në bashkëpunim me Usaidin dhe Unicefin, e kemi projektin të gatshëm, është aplikuar tek thirrja që hap Ministria e Arsimit çdo vit, vjet nuk e kemi fituar, sivjet do të aplikojmë prapë dhe do të aplikojmë deri sa ta fitojmë. Përsa i përketë KUZ-së në Kuman, në Vidhishtë, në pikën 14 është ndërtimi i rrjetit KUZ Njësia Administrative Kuman, ku është e përfshirë edhe Vidhishta. Përsa i përketë shtresave asfaltike çdo vit për rrugët, çdo vit Bashkia Roskovec të paktën Drejtoria e Planifikimit merr kërkesa nga kryetarët e fshatrave, për atë rrugë që e kanë më të nevojshme për fshatin. Përveç shtresave asfaltike, çdo vit miratohet edhe një projekt për rrugët e parcelave..Amarildo-jo nuk është puna vetëm nga kryetarët e fshatrave, se ai kryetari i fshatit mbase se di fare ku i bie ajo rrugë, unë çka të bëj tani..Eneida-ai propozon disa rrugë, ne shkojmë në terren i shikojmë, shikojmë kush janë më të rëndësishme..Amarildo-tani propozimet tona, ne si këshilltar këtu për çka jemi? Eneida-po pra..Amarildo-po pra shënoje këtë po them, se kryetari i fshatit sta ka thënë është e sigurt, edhe banorët janë atje se unë nuk përfaqësoj veten, ata përfaqësoj. Shkoni i pyesni dhe në qoftë se janë në kundërshtim me këtë që po them unë, hajdeni më takoni mua por idea është që këtë rrugë nuk e ka thënë kryetari i fshatit sepse janë hedhur disa shtresa atje, nuk është se nuk janë hedhur. Janë bërë disa punë por kjo është një rrugë afërsisht 1.5-2 km që kalojnë 80% e këtyre banorëve, shkojnë te ullahtet, a e kupton? Kryetari-absolutisht keni të drejtë, unë jam në dijeni të këtij problemi, kemi kërkuar disa herë që të gjendet një rrugëzgjidhje për atë. Ju u shprehët shumë saktë kur thoni që janë bërë disa herë ndërhyrje, mbase jo definitive por terreni atje i ka nxjerrë të pa..Amarildo- tani ai terren është, unë thashë ne nuk kërkojmë asfalt

atje, të bëhet me asfalt..Kryetari-dakort pra se nuk po bëj debat, thjesht dua të tregojë që ka qënë në vëmendje kjo rrugë, se mbase specialistja tani nuk e di, ne të dy e dimë se për cilën rrugë flitet. Unë kam kërkuar disa herë që të shikohet më me vëmendje dhe jam absolutisht dakort me ju që në kuadrin e rishikimit dhe si ne i kemi quajtur këtu restaurimi i shtresave, të merret parasysh në mënyrë të veçantë dhe kjo rrugë. Qëndron problemi që ju thoni por..Amarildo-unë se kam me specialisten e kupton, e di shumë mirë..Kryetari-jo absolutisht, kështu që nuk besoj se ka nevojë për debat. Eneida-përsa i përketë përroit të Vidhishtës, po ne kemi një projekt-ide të ndarë me lote por të hartuar nga studio të jashtme, jo nga Bashkia Roskovec dhe kostoja e këtyre projekteve shkon shumë, është shumë e lartë dhe është e ndarë në tre lote. Patjetër që është në vëmendje, në momentin që ne na është krijuar ndonjë hapsirë në thirrje, e kemi dërguar, nuk na ka ardhur një përgjigje pozitive, po patjetër që e kemi në vëmendje. Kryetari-faleminderit, atëherë fjalën e kishte kërkuar znj.Mira Buzi dhe të përgatitet z.Jorgo. Ermira-përshëndetje, duke qënë se jemi tek projektet infrastrukturore prioritare doja të dija nga grupi i punës, sa nga këto projekte prioritare vijnë që nga viti i kaluar që janë përsëri këtu dhe shoh këtu përshembull disa pika për të cilat doja të dija më konkretisht: ndërhyrje emergjente 3-shi, ndërhyrje emergjente në Njësinë Administrative Kurjan, për çfarë bëhet fjalë konkretisht? Pika 9 ndërtimi i bibliotekës së re të qytetit, a do të ndërtohet një bibliotekë e re apo çfarë, domethënë çfarë është konceptuar në këtë? Ndërsa për të tjerat e kam të qartë, faleminderit. Eneida-sa pika janë nga viti i kaluar, në qoftë se do ti kalojë me radhë të them kush është e re, thjesht me shifër numra nuk të them dot janë 20 apo 23, por ka..Ermira-32 janë gjithsej, sa janë të reja? Eneida-e para ka qënë, e dyta është e re, ndërhyrje emergjente në Njësinë Administrative Kurjan është e re pasi ka patur shkarje nga reshjet e fundit dhe është një projekt emergjent që do aplikohet në thirrjen e Ministrisë së Mbrojtjes. Ermira-konkretisht për cilën bëhet fjalë? Eneida-konkretisht bëhet fjalë për shkarjen në lagjen Kurtaj, për shkarjen në lagjen Buzallarët, për shkarjen për ndërhyrjen në një banesë në..Ermira-bëhet fjalë për rrugë a ndërtime? Eneida-ndërhyrje emergjente do të thotë sipas nevojës diku ka një shkarje rruge, ndërtohet një mur, është një banesë që është në rrezik, pretendohet të ndërtohet një banesë, ka nevojë për një mur pritës tek ura e Vloshit, do ndërtohet muri dhe do përforcohen shpatullat e urës, pra janë ndërhyrje emergjente që vijnë nga fatkeqësitë natyrore. Ali Sollaku është e vitit të kaluar, ndërtimi i kopshtit të përqëndruar është i vitit të kaluar, ndërtimi i godinës së çerdhes Jagodinë është e re..Ermira-restaurimi 6-ta i godinës së çerdhes Arapaj dhe e zyrës së pleqsisë është e re? Eneida- 6-ta është në Jagodinë, është e re. Kryetari-e ke në Arapaj. Leksi- 6-ta thotë Arapaj..Eneida-është lapsus, është Jagodinë. Kryetari-atëherë do na duhet që ta ndryshojmë. Leksi-ça kuptojmë me këtë përshembull? Eneida-në kopshtin e Jagodinës aktualisht..Ermira-çerdhe..Eneida-çerdhe-kopsht, është vetëm një godinë. Ermira-a është kopsht apo është çerdhe? Eneida-po kopsht-çerdhe, është një godinë ku të gjithë fëmijët atje mblidhen. Ermira-jo idea është që të gjithë fëmijët nën moshën 3 vjeç, po nuk lejohet në kopsht nën moshën 3 vjeç. Eneida-unë flas për pjesën e godinës infrastrukturore, ajo godinë ka një zyrë të veçantë që është menduar ti jepet kryeplesqsisë së fshatit dhe është bërë një projekt-ide për restaurimin e godinës..Ermira-është bërë projekti apo është bërë restaurimi? Eneida-është projekt prioritar që pretendojmë ta bëjmë brenda 2026-tës dhe është bërë projekti për restaurimin e kësaj godine. 8-ta përmirësimi i stacionit të pompimit Suk-Arapaj dhe përmirësimi i rrjetit kullues është i ri, ndërtimi i bibliotekës së re të qytetit është i ri, restaurimi i shkollës Rrahmen Dashi është i ri..Ermira-a mund të na jepni diçka informacion për këtë bibliotekën e re të qytetit? Eneida-po, nga Bashkia Roskovec është bërë..Leksi-o drejtoreshë na kthe përgjigje vetëm për ato çfarë të pyesim sepse këto i kemi

lexuar..Kryetari-ju lutem pak qetësi, si ishte propozimi Leksi, të lutem përsërite? Leksi-kisha një propozim të tillë që ato pyetjet që bëjmë ne, që i kemi si të paqarta le të na përgjigjet drejtoresha e Urbanistikës, të tjerat ska pse ti lexojë të gjitha për arsye sepse..Kryetari-jo duhej një numër në fakt që mund ta kishte bërë, megjithatë dëgjo..z.Jorgo të lutem të jemi pak të vëmendshëm..Eneida-përsa i përketë bibliotekës, në planin e përgjithshëm vendor të miratuar në 2010 është një zonë e cila është e parashikuar që të ketë një bibliotekë qyteti, dhe nga drejtoria e Planifikimit është hartuar detyra e projektimit sipas ligjeve në fuqi për bibliotekën, është parashikuar në buxhet biblioteka dhe mendojmë të realizohet. Leksi-objekti i ri? Eneida-po. Leksi-vendi dihet ku është? Eneida-po, është dhe e aksesueshme dhe tek faqja e planifikimit të territorit, është tek pylli me pisha, është një sipërfaqe atje që është e dedikuar afër shkollës Alush Grepcka. Kryetari-kam vetëm një paqartësi në qoftë se mundem. Ne po flasim për projekte infrastrukturore prioritare dhe në mënyrën sesi e kuptoj unë kemi të bëjmë me projekte të gatshme tashmë, që janë projekte që janë bërë gati dhe janë në pritje të dritës së financimit të tyre, dhe normalisht që duhet të ketë një plan të tillë çdo bashki dhe deri këtu jam dakort. Ajo që unë nuk kuptoj është, në qoftë se flasim për bibliotekën dhe ne e kemi miratuar në buxhet fondin, ky nuk është më projekt prioritar, ky është projekt që e ka marr tani rrugën, dhe e dyta kur themi ndërhyrje emergjente në Njësinë Administrative Kurjan, ose do ta trajtojmë tek emergjenca, pra ose është tek emergjenca dhe do ta trajtojmë tek emergjencat ose është në diku ndryshe nga projektet prioritare sepse këto projektet prioritare ne thjesht i kemi vënë si radhë dhe mbase nuk realizohen dhe për 10 vjet në qoftë se nuk vjen financim, pra mos duhet që nga kjo listë ne ti rishikojmë të dyja këto që unë thashë? Mund të ketë dhe të tjera por dy që më vranë syrin, se doja ta bëja që më përpara këtë pyetje. Pra në qoftë se kemi të bëjmë me ndërhyrje emergjente, nuk do e bëjmë projekt prioritar se prioritareve su vjen radha për 10 vjet, dhe këtë që ju thashë që ishte biblioteka, kur kaluam buxhetin ne e kemi miratuar pra, kjo është e miratuar presim që të zbatohet, kështu që nuk është më prioritar mendoj. Eneida-një nga kushtet që ne kemi nëpër thirrjet që ne aplikojmë siç është rasti i bibliotekës dhe emergjencave civile, është sa prioritare ose a është parashikuar ky projekt si projekt prioritar sepse ne nuk e kemi shpikur këtë projekt-vendim, por na është kërkuar nga thirrje të vazhdueshme, që është prioritar ky? Keni një vendim Këshilli që ky projekt është i rëndësishëm? Dhe këtë gjë po bëjmë 4 vjet që e zbatojmë. Patjetër edhe biblioteka ka kaluar në buxhet por është një projekt që kërkon hartim projekti nga një studio profesioniste e jashtme, jashtë bashkisë dhe për çfarë do lloj arsye mund të ndodh që mund dhe të mos realizohet, kështu që ajo prapë është prioritar për ne, plus që e kemi të miratuar në planin e përgjithshëm vendor si projekt prioritar për tu bërë. Kryetari-dakort pra, por a e kemi miratuar në buxhet? Eneida-po. Kryetari-do të thotë që ajo këtë vit duhet të fillojë dhe të ndërtohet, për çfarë thirrje flasim tani se spo e..Dr.Financës Orgesa-për bashkëfinancim se ne kemi miratuar pjesën tonë..Kryetari-dhe unë prapë i qëndroj që ne smund të kemi një projekt për emergjencën, emergjenca është diçka që ndodh rishtaz dhe ne kërkojmë një zgjidhje, që të cilën mundet që..Eneida-tek emergjencat janë emergjenca që kanë ndodhur brenda këtij muaji dhe është vendosur sepse ne brenda këtij muaji kemi aplikuar për thirrjet për emergjencat që janë hapur nga Ministria e Mbrojtjes. Kryetari-dëshironi që ta ndani veç këtë, që të marri një vendim të veçantë si emergjencë për këtë projektin? Flas gjithmonë për këtë që ju quani emergjencë sepse kjo radhë prioritare na thotë që ne nuk mund të zgjidhim këtë emergjencë në fshatin Kurjan pa zgjidhur një në radhë..Sekretare e Përgjithshme Delina-thjesht për ta theksuar sepse Eneida e tha, në momentin që ne aplikojmë në thirrje në rastin e emergjencave, kriter është edhe nëse ky projekt është prioritar me vendim Këshilli Bashkiak apo jo dhe prandaj është futur tek

projektet prioritare. Kryetari-dakort, fjalën e ka kërkuar z.Jorgo. Jorgo-në vazhdim të kolegut që ngriti evidentimin e përroit të Vidhishtës edhe në respekt të të gjithëve por unë para 2 vitesh e kam ngritur këtë, që ky përroi i Vidhishtës fillonte nga lart dhe dilte deri në fund në kolektor apo jo? Nga ura e rrugës për në Marinëz deri në kolektor ky përroi është i bllokuar, të gjithë fermerët kanë ardhur dhe kanë bërë kërkesë po bëjnë 2 vjet, hë Elmaz nuk e di e kam gabim? Po bëj 2 vjet që e kam kërkuar..Kryetari-patjetër qëndron kërkesa juaj, shqetësimi juaj por jo në brendinë e këtij projekt-vendimi, jemi me projektet prioritare. Jorgo-në qoftë se ka ndonjë projekt na bën mirë dhe neve, dhe ne jemi taksapagues në atë zonë që paguajmë taksat dhe duam rrugë të vemi në parcela. Kur bëhet rehabilitimi i përroit detyrimisht vete deri në fund, edhe rruga edhe përroi pastrohet apo jo? Nuk e di mbase pastrohet përroi dhe nuk bëhet rruga, nuk e di mbase ka ndonjëri që mund të më japi ndonjë shpjegim? Kryetari-absolutisht shqetësimi dhe problematika që ju ngrini është e drejtë..Jorgo-pastrohet përroi dhe nuk bëhet rruga që ne të vemi në parcelat tona, tani aty tek rehabilitimi i përroit ai ka fillimin dhe derdhjen në lumin që vjen Seman, kjo është projektuar? Po bën 2 vjet që është kërkuar nga Këshilli dhe di që 15 taksapagues të zonës kanë ardhur dhe kanë kërkuar që të venë në trojet e tyre ku ata kanë mbjellë, rruga është për të dëshiruar nuk hyn dot, do ndërhyet një ditë apo, se e kemi kërkuar? Kryetari-faleminderit Gogo, ja të dëgjojmë përgjigjen. Kryetari i sqaron drejtoreshës pjesën se ku ndodhet kjo rrugë. Eneida-përroi i Vidhishtës projekti që ne kemi është vetëm përgjatë fshatit Vidhishtë, i ndarë në 3 lote..Jorgo-po mirë, po do e bëni edhe në Marinëz ju? Eneida-jo..Jorgo-sdo e çoni deri në fund? Eneida-jo..Jorgo-jo meqënëse është bërë deri në Vidhishtë, dhe deri këtej pastaj ujrë mos të rrjedhin, do ti bllokoni? Eneida-unë po them kam një projekt-ide, nuk po them që do e nisim nesër dhe do vazhdojë të bëhet nesër..Jorgo-ai është pastruar deri diku dhe pastrimi ka ngelur nga..deri në grykërrjedhjen e Semanit..Eneida-unë flas për projektet që kanë rehabilitimin e përroit të Vidhishtës, jo pastrimin nga bordi i kullimit. Kryetari-mirë faleminderit, fjalën e kishte kërkuar Pegiola dhe përgatitet z.Elmaz. Pegiola-përshtendetje të gjithëve,fillimisht do doja që të ishin pak më të qarta pikat dhe të kishte një renditje më të mirë, domethënë ato që janë pika më prioritare të ishin në fillim dhe ato që janë pika që ndoshta nuk do zbatohen këtë vit por janë prioritare për 2027, të ishin nga fundi. Nuk jam kundër rikonstruksionit të shkollave dhe çerdheve por që ka çerdhe që janë ndoshta edhe më keq, ne nuk i shohim fare po i mbyllim, i zvogëlojmë, i çojmë çik më larg ta kenë çerdhen. Fillimisht duke qënë se e cekën të gjithë rehabilitimin e përroit të Vidhishtës, unë do doja që të ishte pikë nga fillimi jo nga fundi dhe përveç rehabilitimit të përroit ka toka bujqësore që nuk kanë rrugë. Unë e ngre si problem edhe se babai im ka toka aty, por që aty mezi kalon traktori jo më të kalojë një njeri normal me makinë apo të kalojë dikush që ka shtëpinë aty. Diçka tjetër që doja, që ne e kemi aktualisht një bibliotekë në qytet, pse mos të restaurohet por të krijohet nga fillimi, për disa firma që duan të zhvasin, duan të hapin fondet e tyre, duan të krijojnë mundësitë e tyre. E mira do ishte që disa nga pikat edhe të ishin në diskutim të dytë, për rikonstruksion biblioteke ose hapsira të reja në bibliotekën që kemi, jo diçka të re nga fillimi kur ne e kemi një ekzistuese, apo atë që kemi ta prishim dhe të hapet një e re se duhen prishur ca pisha, duhen prishur ca pyje. Pikë tjetër është pjesa e krijimit të shtegut të biçikletave. Kemi mjaftueshëm njerëz që i japin biçikletave dhe duhet patjetër një krijim i shtegut të biçikletave? Edhe diçka tjetër, krijimi i parkut zero karbon, po e dëgjojë sot këtu, nuk është se e kisha dëgjuar ndonjëherë që kaq vend i vogël sa jemi ne, ça qyteti i vogël që jemi të krijohet një park i posaçëm, ndërkohë që ne nuk di të ketë njerëz në rrugë të kalojnë në trotuar normal jo më të ketë park, kaq kisha për momentin. Eneida-përsa i përketë renditjes, ne si drejtori nuk jemi askush që të vendosim prioritare kush është më i rëndësishëm nga

tjetri dhe cilët janë 5 të parët, sepse shumica e këtyre projekteve janë thirrje që hapen. Në qoftë se Ministria e Arsimit hap një thirrje për arsimin, ne do aplikojmë jo sepse është më emergjente nga përroi i Vidhishtës por nuk e përmban thirrja, është e kufizuar në drejtimin arsimor. Pra në qoftë se Ministria e Mbrojtjes hap thirrje për emergjencat, nuk aplikon dot me shkollën por sipas kushteve të tyre dhe këto nuk i vendosim dot ne cilat do hapen, cilën do fitojmë dhe cilën do lëmë për në 2027. Përsa i përket përroit të Vidhishtës po çdo vit aplikohet, kërkohet nga kryetari i fshatit për rrugë parcelash dhe çdo vit ka karikime, ka rrugë të reja për të shtuar me çakull por patjetër që nuk janë të gjitha sepse të paktën një rrugë për fshat është bërë. Biblioteka që ne kemi në fakt është Kinemaja e qytetit dhe ka një hapsirë që i është dhënë bibliotekës. Kinemaja nuk funksionon, ngjysma është bibliotekë, patjetër që ka nevojë për një bibliotekë sepse nuk kemi. Shtegu i biçikletave është gjithashtu një nga thirrjet e Ministrisë së Turizmit, që ne mund të krijojmë diçka në Roskovec për ta kthyer turistik, është thjesht një shteg që mund të bëjmë një maratonë një herë në vit. Park zero karbon mund të quajmë një park sado të vogël, i cili nuk ka ndikime nga betoni, nga infrastruktura siç është përshebull lulet fotovoltaike, pra që nuk ka konsum dhe nuk ka çlirim karboni. Kryetari-mirë faleminderit, fjalën e kishte kërkuar z.Elmaz, përgatitet Leksi. Elmazi-faleminderit Kryetar, duke parë problemet në tabelën të cilën na e ka paraqitur grupi i punës, janë disa gjëra të cilat ne i kemi kaluar në vendimet e para të Këshillit. Po e marr nga e para, biblioteka ka kaluar ndonëse mund të kisha rezerva në drejtim që të restaurohej ajo që ishte që mos të bëhej kjo e reja, nuk niset se do të pritet një pishë apo dy pisha fare, niset sepse duhet bërë që të hapim prespektivën e njerzve të shkollluar, të cilët të paraqiten të marrin librat dhe të studiojnë, që mos të rrinë rrugës por të shkojnë nëpër biblioteka, kjo është e nevojshme. E dyta, shikoj të rëndësishme në ndërgjegjen time dhe të Këshillit, Ngjeqari e ka ngritur disa herë dhe ju thoni do bëhet ky ujësjellësi, një çezëm atje ka 4 vjet që kërkohet në Këshill, për respekt të Këshillit, për respekt të atij populli pavarësisht se i majtë apo i djathtë, a kërkon ujë për të pirë dhe për të larë, çfarë është bërë dhe çfarë do të bëhet? Flitet për përroin e Vidhishtës, njëherë për atë të jenë në dijeni shumica e këshilltarëve, është e bordit të kullimit dhe nuk është e bashkisë, por ajo nga varrezat ose ish ura atje dhe deri tek ura ajo është pastruar nga bordi i kullimit dhe e ndjekë bordi i kullimit, në dijenin time. Jorgo-po mirë po ne që paguajmë taksat? Elmazi-e ka bordi i kullimit, juve verifikojeni këtë që them unë, jam me ju unë nuk jam kundra, ta mbarojë..Bordi i kullimit ka 18 metër të tijat, sheshin e tij, por ama a duhet rrugë apo jo? Nga ura që ishte ish lopë e deri tek ura e dytë që është jo më pak se 5 km, ka qënë rrugë që kalonin mjetet, sot është bërë rrugë që nuk kalon asnjë lloj mjeti, për këtë është ngritur disa herë dhe ju se vini fare ujin në zjarr. Pse se bëni, ça ju pengon, ça nuk keni fond të vij një skrep? Për mua është thjeshtë neglizhim. Po hyj në parcelat e arave për të cilat ne u japim taksat ju zotrinj të bashkisë, paguajmë taksat ne, i paguaj çdo vit unë skam, jam 9 veta unë që paguaj në bashkinë time, atëherë pse nuk bëni një rrugë në bllok? Ju thoni është bërë, e di ku është bërë rruga? Të them unë ku është bërë, është bërë në sera, po në blloqet ku mbillet gruri, misri dhe fasulet e të tëra nuk është bërë asnjë rrugë. E marrim nga 8/1 deri tek 8/8 që janë 180 hektarë, vetëm tek 8/8 janë bërë atje se janë sera, atëherë kur do bëhet? Prandaj që janë disa gjëra që duhen të ngrihen por unë mendoj dhe propozoj juve Kryetar i Këshillit, që në një mbledhje tjetër të vij drejtori i zyrës së urbanistikës, të cilët merren me këtë punë dhe të na japi sqarim, faleminderit. Kryetari-faleminderit z.Elmaz, fjalën e ka z.Leksi Goga, të lutem vetëm për diçka, të qëndrojmë brenda këtij projekt-vendimi. Për shqetësimin që ngriti z.Elmaz do ti rikthehemi mbase edhe njëherë në fund tek diskutimet dhe të parashikojmë thirrjen e..Leksi-po pra, nuk i kam që të zgjerohem në pika të tjera. Pikën e parë kemi ndërtimin e Unazës Perëndimore, i

cili me buxhetin e vitit 2026 ne e kemi kaluar si riasfaltim i rrugës, të cilat kjo ka dhe 3 nënobjekte. Para se të vemi tek nënobjektet, të cilat i kuptojmë që është projekt infrastrukturor dhe nuk i kemi akoma mundësitë për ti ndërtuar këto, ka dhe disa gjëra të tjera drejtoreshë. Bllokimi i ujrave të zeza të cilat i kalojnë familjarëve mbrapa shtëpisë dhe janë problem për higjenën dhe për aromën që shpërndahet gjatë stinës së verës, plus që dhe disa familjarë aty tek pjesa e kësaj unazës perëndimore ankohen për pjesën e çarjes së kanaleve të ujrave të zeza, që kanë dalë nëpër sipërfaqet dhe nëpër oborret e familjarëve, në qoftë se e ke parasysh se ku është, domethënë që është kalçetua, është një tunel atje dhe pjesa poshtë e familjarëve të Hajdinëve. Në rast se mundet të futet tek ky nënobjekti këtu vetëm për të ndërtuar, ose të mbyllet ose të ndërtohet, të jetë më eficient. E dyta, për restaurimin e shtresave asfaltike në rrugët e njësive administrative ose në Roskovec, me gjuhën e teknikës ndoshta e kemi të qartë, por dua shqip dhe për shqip, përse janë projekte këto, çfarë sepse thotë shtresa asfaltike, ça do restaurojmë ne te rrugët të cilat kanë mbaruar dhe do restaurohen apo, se po të ishte tek rrugët e parcelës do shkruante rrugë parcelash këtu, këtë kam. Eneida-ndërtimi i unazës perëndimore ka 3 nënobjekte, është vendosur sepse bëhet fjalë për dy nënobjektet e tjera të cilat nuk janë të parashikuara te buxheti. Përpos unazës dhe njëra nga rrugët që futet tek shtresat asfaltike të qytetit të Roskovecit është pikërisht kjo, pra tek pika 20 restaurimi i shtresave asfaltike në rrugët e qytetit Roskovec është dhe unaza e përfshirë, por nuk është vetëm ajo, ka dhe disa rrugë të tjera brenda në qytet që janë me çakull dhe bëhet fjalë për sistemim të shtresave, ato që janë dhe do bëhen me asfalt. Leksi-ato rrugë që i kemi kaluar në 2026 në buxhet? Eneida-jo,ato që nuk janë bërë. Leksi-se kjo thotë restaurimi i shtresave asfaltike, rrugë të mbaruara që mund të kenë çeduar apo rrugë..Eneida-jo jo, rrugë të reja që janë me çakëll, kanë gropa dhe do restaurohen në shtresa, pra restaurimi i këtyre shtresave deri në asfalt, jo asfalti ekzistues. Përsa i përketë KUZ-së, tek sistemimi i unazës që unaza është rrugë, nuk është e përfshirë, bëhet fjalë vetëm për shtresat e rrugës dhe këtë po mund ta kemi parasysh për një projekt tjetër. Leksi-se ajo është më emergjencë se kushdo tjetër, ajo pjesë e kanalit të ujrave të zeza, më emergjente se këto nënobjektet e tjera. Kryetari-mirë faleminderit, do mbahet në konsideratë ky shqetësim. Fjalën e ka kërkuar Zhaku. Zhaku-përsëritje të gjithëve, këtu janë 32 pika dhe nuk keni kapur një pikë që është më kryesorja. Ne në fshatin Suk 1 kemi një hall të madh, koshat e mbeturinave janë të gjithë të dëmtuar, janë të gjithë të vendosur në vende jo të mira, janë burim aksidenti dhe ky është problem i madh për zonën tonë. Janë të gjithë koshat të dëmtuar, është një situatë alarmante. Kjo është gjëja kryesore dhe halli më i madh që kemi ne si zonë, faleminderit. Eneida-po qëndron, por ne kemi bërë projektet prioritare si drejtori, projektet infrastrukturale. Për koshat po kemi një projekt që kemi aplikuar..Zhaku-ky është projekti më i domosdoshëm..Eneida-por nuk përfshihet tek projektet infrastrukturale..Zhaku-është gjendje alarmante, ti je vet e zonës..Eneida-po pra,e pranojë por nuk është e përfshirë..Zhaku-të gjithë koshat janë të dëmtuar, asnjë kosh nuk është i saktë duke filluar nga Xhamia që është vend i shenjtë, hidhen mbeturinat përballë Xhamisë, nuk ka një vend të caktuar, mos të ketë kosha në çdo shtëpi një kosh por të jetë një vend i caktuar me beton, të vendosen katër kosha dhe të jenë të saktë sepse do marrin sëmundjen fëmijët. Unë kam video, kam foto por nuk dua ti publikoj këtu, ja kam dërguar Nënkryetarit Maksit por është gjendja shumë alarmante, ju lutem shikojeni këtë si pikë dhe i jepni një zgjidhje sa më të shpejtë. Kryetari-faleminderit, fjalën e kishte kërkuar z.Jorgo, ju lutem përmbledhtas sepse e keni kërkuar qëparë..Jorgo-përmbledhur, nuk kemi gjë me drejtuesen por projekti që na është dhënë besoj se të gjithë patën ato kërkesat dhe vërejtjet, të rishikohet, ta votojmë kundër që të na vij i plotë herës tjetër. Elisabeta-për pjesën e rrugës doja të thoja, ju e keni

parë edhe vet për pjesën kur vjen nga Roskoveci për në Suk, pasi gropat që janë krijuar rrugës, besoj se duhet ta kesh vënë re edhe vet që është shumë gjendje e..Eneida-përsa i përket të gjithë bypass-it siç quhet në gjuhën teknike e ka ARRSH-ja, duke filluar nga kthesa e Marinzës deri në Strum është një segment rrugor që e menaxhon ARRSH-ja dhe ne mund ta transmetojmë kërkesën, shqetësimin, po patjetër por që nuk mund ta parashikojmë ne në projektet tona. Kryetari-mirë faleminderit, dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje dhe për diskutim? Nuk ka. Kryetari-mirë atëherë, të nderuar këshilltar ju ftoj të votoni projekt-vendimin “Për miratim të projekteve prioritare infrastrukturore për Bashkinë Roskovec për vitin 2026”..Jorgo vazhdon diskuton. Kryetari-z.Jorgo të lutem pak qetësi sepse disa herë..të lutem pak më i përmbajtur. Atëherë të nderuar këshilltar ju ftoj të votojmë projekt-vendimin “Për miratim të projekteve prioritare infrastrukturore për Bashkinë Roskovec për vitin 2026”..Jorgo vazhdon të flasë. Kryetari-të lutem jam duke folur, z.Jorgo të lutem pak më i përmbajtur, jam duke ftuar këshilltarët të votojnë projekt-vendimin “Për miratim të projekteve prioritare infrastrukturore për Bashkinë Roskovec për vitin 2026”, me ndryshimin e emërimit të pikës 6, nga restaurimi i godinës së çerdhes Arapaj, e kemi çerdhes Jagodinë dhe zyrës së pleqsisë. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin me ndryshimin si më sipërpërmendur dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 vota kundër J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo. Miratohet. Kryetari-atëherë me 11 vota pro, 3 kundër..Jorgo-ku i ke ti, ja numëroj..Kryetari-miratohet ky projekt-vendim,z.Jorgo..Në sallë ka diskutime midis këshilltarëve dhe zhurmë. Kryetari-z.Jorgo të lutem pak më i përmbajtur. Jorgo-kur ngre një shqetësim dhe voton pro? Kryetari-të lutem pak më i përmbajtur z.Jorgo. Diskutimi nga Jorgo vazhdon në sallë. Kryetari-atëherë 2 minuta pushim sa të qetësohet këshilltari. Mbledhja ndërpritet dhe këshilltarët marrin 2 minuta pushim. Pas pushimit rifillon përsëri mbledhja. Kryetari-atëherë të nderuar këshilltar, shpresoj që e kemi qetësuar pak situatën në sallë dhe vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës.

7.Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari-dëshironi që të dëgjojmë relacionin? Floriana-jo Kryetar se e kemi parë..Këshilltarët shprehen se e kanë parë. Kryetari-pra jeni njohur me relacionin, atëherë ju lutem cili e kërkon fjalën për pyetje meqënëse këtu kemi drejtoreshën? Po fjala për ju z.Elmaz. Elmazi-i nderuar Kryetar, ne e kemi diskutuar materialin i cili na është paraqitur, dhe në komision, prandaj jemi plotësisht dakort që të kalojë si material, grupi kush ka pyetje ler të bëj. Kryetari-faleminderit z.Elmaz, dikush tjetër për pyetje apo për diskutim e kërkon fjalën në lidhje me këtë projekt-vendim? Përsa kohë nuk kemi pyetje dhe diskutime, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 3 vota abstenim J.Begaj, A.Hoxha, A.Pelo. Miratohet ky projekt-vendim.

8.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-kush nga këshilltarët e kërkoi fjalën në lidhje me atë që ngriti z.Elmaz, përsa i takon thirrjes në mbledhjen e ardhshme të Drejtorit të Urbanistikës dhe Investimeve? Do ju lutesha dhe këshilltarëve a jeni dakort që në mbledhjen e radhës të thërrasim Drejtorin e Investimeve dhe Urbanistikës? Leksi-po, Drejtorin e Investimeve në bashki..Ermira-po, që ti bëjmë kërkesën konkrete për pyetjet që kemi. Kryetari-po e sekretojmë tani kërkesën, do ju lutesha këshilltarëve që

kanë pyetje specifike ti sekretojnë tani, ti bëjnë tani këto pyetje në mënyrë që ti sekretojmë. Ju lutem përsa kohë që në mbledhjen e radhës do të thërrasim Drejtorin e Investimeve, do ju lutem që kush ka pyetje specifike ta bëj tani në këtë mbledhje, në mënyrë që të jetë i përgatitur. Për pyetje në lidhje me këtë çështje që po diskutojmë, në këtë thirrje e keni ju z.Jorgo, keni fjalën. Jorgo-rehabilitimi i përroit të Vidhishtës, po bëj 2 vjet, do bëhet një ditë? Kryetari-po faleminderit, u sekretua kërkesa juaj. Pegiola-kisha diçka shtesë, duke qënë se jemi dhe tek pika e pyetjeve dhe diskutimeve, para nja një jave është djegur një shtëpi në Kurjan, tek lagja e Toranjakëve. Kryefamiljari aktualisht është me ndihmë ekonomike por do doja ti jepnit prioritet, se duke qënë se i është djegur e gjithë shtëpia dhe ata aktualisht thuajse jetojnë jashtë, kanë vetëm një dhomë që u është bërë nga bashkia para disa vitesh dhe shtëpia tjetër i është djegur. Nëse është prioritet tek emergjencat le të jetë prioritet, nuk është se unë po e ngre si shqetësim ngaqë e kam familjar të timin, por dua që të gjitha shqetësimet duke qënë se është emergjente dhe ne kemi fonde emergjence nga zjarrfikëset dhe këto, të vendoset si prioritet. Kryetari-po po e qartë, dhe me sa di unë është raportuar, shumë e drejtë faleminderit. Z.Amarildo do doja ndonjë pyetje specifike që mund të kishim. Amarildo-faleminderit edhe një herë Kryetar, siç e thashë për pjesën e përroit do doja të dija realisht si do realizohet, a kanë projekt? ata thonë që kanë sepse përdërisa aplikojnë çdo vit e kanë një projekt, por projekti mendoj që është bërë gabim ose studimi çka kanë bërë ata zotrinjtë, sepse nuk e kanë përfshirë fare pjesën e ujrave të zeza për pjesën e projekteve prioritare siç e rithashë edhe njëherë, nuk është fare në projektet prioritare. Tani se çka bën bashkia për pjesën e ujrave të zeza dhe nuk e bini këtu, tani unë sdi gjë se çka keni bërë atje..Realisht ka një plan konkret për të bërë ujrën e zeza të atij fshati, se është prag epidemie atje o zotri, çdo vit është e njëjta situatë, nuk hapin dot dritaret ata banorët atje, ata që kanë ngelur të paktën. Kryetari-po të kuptoj, besoj që ju jeni në dijeni që nuk i lejohet asnjë qytetari që të derdhi ujrën e zeza në përrua dhe duhet të keni një gropë skeptike, dhe në qoftë se na thoni kështu siç na thatë tani, unë besoj se ata duhet të kenë detyrimin që mos ti derdhin atje. Amarildo-po pra, ata i derdhin atje sepse nuk kanë asnjë mundësi tjetër për të mos i derdhur atje, sepse në banesat e shumicës..Afrim ti dhe unë jemi nga ajo zonë, në banesat e shumicës së atyre qytetarëve kanë nga 250-300 metër truall dhe atje është bërë ndërtim, ore i arrestoni i fusni në burg..Kryetari-jo mor nuk është ajo, por të lutem që të jeni pak më konçiz..Amarildo-idea është çka zgjidhje do ti jepni për ujrën e zeza sepse..Kryetari-po më drejtoheni mua, po ju them që..Amarildo-po të drejtohem ty sepse je drejtues, të lutem mbaj shënim..Kryetari-të lutem pyetje jo diskutimin, ruaje për ta përballur me drejtorin se për këtë arsye po e thërrasim..Amarildo-pyetja është kjo, a ka tek projekti që keni bërë për përroit të Vidhishtës ujrën e zeza, a janë përfshirë atje? Kryetari-do përgatitet drejtori dhe do vij që të japi një përgjigje. Amarildo-ok, e dyta: a ka një mundësi bashkia përveçse të presi që ti ndizet ndonjë dritë jeshile dhe blu, të bëj diçka atje vet me fondet e veta sepse mendoj është e realizueshme duke e ndarë me lote të paktën, sepse nuk është ndonjë distancë e madhe. Kryetari-mirë pra, po lëre diskutimin jemi tek pyetjet.. Amarildo-pjesa tjetër, a do ndërhyet të paktën për të hedhur çakull dhe për ta hapur deri diku pjesën e rrugës nga pompa e fshatit Vidhishtë deri afër rrugës së Shushenjve që i thonë Luar, këto janë më kryesoret. Dhe diçka tjetër meqënëse jemi këtu, mos ta rimarr sërish fjalën, e kam kërkuar disa herë dhe është për turp ta kërkojë prapë, ata pak nxënës që kanë ngelur atje u rrezikohet jeta çdo ditë, të paktën në Vidhishtë dhe në Marinëz, nuk po e kërkoj për Luar se e di që nuk ka aq qarkullim. Në Vidhishtë dhe në Marinëz ja kam kërkuar, rikërkuar 2 pengesa të shkolla, është turp ose do ti bëjmë vet por është e pafalshme, ta flas nga ana njerëzore sinqerisht është e pafalshme. Në Marinëz dhe në Vidhishtë duhen me patjetër, fëmijët

rezikojnë jetën, ore ti mbajmë këta që kemi. Kryetari-jo është e qartë, nuk ka nevojë për sqarime, mendoj se qëndron shqetësimi dhe do përpiqemi ta adresojmë, z.Leksi e ka fjalën. Leksi-dua të bëj një pyetje specifike për afatet e fillimit dhe mbarimit të punimeve, që kanë firmat në zbatimin e projekteve. Kanë qënë korrekt? Dhe e dyta, në rast se nuk kanë qënë korrekt, ka pasur penalitete? Dhe çfarë lloji kanë qënë penalitetet? Dhe tjetra, në rast se nuk ka qënë puna ashtu si duhet cilësore, është marr puna në dorëzim a nuk është marr, dhe afatet kohore deri sa qëndron pjesa e marrjes apo jo së punës në dorëzim nga bashkia? Kryetari-për cilën periudhë e doni informacionin? Leksi-që kur kemi filluar në Këshillin tani, periudhë 4-5 vjeçare. Kryetari-atëherë 2023 e mbrapa? Leksi-po 2023 e këtij meqënëse atëherë kemi filluar mandatin si anëtar Këshilli. Kryetari-po faleminderit, tjetër kush në lidhje me ndonjë pyetje specifike sa i takon investimeve në bashki? Nazmiu-në lidhje me investimet që bëhen, a merret parasysh afati kohor nga bashkia për ti marr në dorëzim investime të ndryshme? Sepse vjen afati 1 vjeçar që ai e ka për të bërë investimin tani për rrugën, dhe vjen fundi pa e marr në kontroll i humbet ajo e drejta e tij për të kaluar një fond atje, rrugë apo investimi që ka bërë. Kryetari-e drejtë, e sekretuam dhe pyetjen tuaj, po Zhaku..Zhaku-është bërë një investim tek lokali i Lani Gllavës për një urë dhe ka ngelur ngjysëm, ura është e hapur po bën 3 muaj dhe është burim aksidenti, do mbaroj ai projekt po apo jo? Elisabeta-nuk e di do jetë ura që lidh Strumin me Sukun aty tek kthesa, është pjesë e investimeve? Të bëhet me standarte duke parë që aty kalojnë edhe trajlera, të bëhet pak më e mirë. Kryetari-duke ju falenderuar të gjithëve për pjesëmarrjen në këtë mbledhje, për mënyrën sesi jeni kaq të ndjeshëm ndaj gjithë problemeve që kanë qytetarët, unë e deklaroj të mbyllur mbledhjen e muajit Janar e Këshillit të Bashkisë Roskovec, faleminderit të gjithëve.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Afrim Plaka